



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry,
Entrepreneurship and Trade

Programi
për
Eliminimin e Barrierave në Tregti Sipas Neneve
34 - 36 TFBE
(2021– 2025)

LISTA E SHKURTESAVE

AKS - Agjencia e Kosovës për Standardizim
CEN – Komiteti Evropian për Standardizim
CENELEC – Komiteti Evropian për Standardizimin Elektroteknik
CEFTA - Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore
DI-DIC - Departamenti i Industrisë - Divizioni i Infrastrukturës së Cilësisë
BE - Bashkimi Evropian
KE - Komisioni Evropian
GJED - Gjykata Evropiane e Drejtësisë
ETSI – Instituti Evropian i Standardeve të Telekomunikacionit
EA - Akreditimi Evropian
EURAMET - Shoqata Evropiane e Instituteve Kombëtare të Metrologjisë
LLM– Lëvizja e Lirë e Mallrave
MINT – Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
ME - Ministria e Ekonomisë
MSh - Ministria e Shëndetësisë
MPB - Ministria e Punëve të Brendshme
MBPZhR – Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural
KNjN – Klauzola e Njohjes së Ndërsjellë
SHA - Shtetet Anëtare
PKZMSA - Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit
MSA - Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
RSFJ - (ish) Republika Federale Socialiste e Jugosllavisë

TFBE - Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian
BTT - Barrierat Teknike në Tregti
WELMEC - Bashkëpunimi Evropian në Metrologjinë Ligjore
OBT– Organizata Botërore e Tregtisë

I. Hyrje - Sistemi Ligjor Evropian në lidhje me lëvizjen e lirë të mallrave

Harmonizimi i Rregullave për Produkte në Nivelin e BE-së

Në Bashkimin Evropian (BE), harmonizimi i ligjit (ose thjesht harmonizimi) është procesi i themelimit të standardeve të përbashkëta në të gjithë tregun e brendshëm. Edhe pse secili shtet anëtar i BE-së ka përgjegjësinë kryesore për rregullimin e shumicës së çështjeve brenda juridiksionit të vet, dhe rrjedhimisht secili ka ligjet e veta, harmonizimi synon të: krijojë qëndrueshmëri të ligjeve, rregulloreve, standardeve dhe praktikave, në mënyrë që të njëjtat të aplikohen për bizneset që veprojnë në më shumë se një shtet anëtar, dhe në mënyrë që bizneset e një shteti të mos fitojnë ndonjë përparësi ekonomike ndaj bizneseve në shtetin tjetër, si rezultat i rregullave të ndryshme.

Objektivat e direktivave të para të harmonizimit pas krijimit të Komunitetit Ekonomik Evropian u përqendruan në eliminimin e barrierave dhe në lëvizjen e lirë të mallrave në tregun e përbashkët. Këto objektiva tani po plotësohen nga një politikë gjithëpërfshirëse, me synimin që vetëm produktet e sigurta dhe produkte që janë në përputhje në të gjitha aspektet tjera, të gjejnë rrugën e tyre në treg, në mënyrë që operatorët e ndershëm ekonomikë të mund të përfitojnë nga kushtet e drejta dhe të barabarta, duke promovuar në të njëjtën kohë një mbrojtje efektive të konsumatorëve dhe përdoruesve profesionalë të BE-së dhe një treg të vetëm konkurrues të BE-së.

Kërkesat e BE-së në lidhje me mallrat jo të harmonizuara ose aspektet e mallrave në treg

Krahas iniciativave legjislative për të parandaluar pengesat e reja dhe për të promovuar lëvizjen e lirë të mallrave me aplikimin e harmonizimit, zbatimi sistematik i parimit të njohjes reciproke i mishëruar në legjislacionin e pa harmonizuar të BE-së është ndjekur poashtu. "Rregulloret teknike kombëtare", të cilat ende ekzistojnë në sektorët e pa harmonizuar iu nënshtrihen dispozitave të neneve 34 deri 36 të Traktatit për Funksimin e Bashkimit Evropian (TFBE), të cilat ndalojnë kufizime sasiore ose masa që kanë efekt të barasvlershëm.

Në aktgjykimin e rastit "Dassonville", Gjykata e Drejtësisë shprehu mendimin se të gjitha rregullat e tregtisë të miratuara nga Shtetet Anëtare të cilat janë në gjendje të pengojnë, në mënyrë të drejtpërdrejt ose indirekte, qoftë realisht apo potencialisht, tregtinë brenda Komunitetit, konsiderohen si masa që kanë një efekt të barasvlefshtë me kufizimet sasiore. Arsyeimi i Gjykatës elabrohet më tej në aktgjykimin "Cassis de Dijon", i cili përcakton parimin që çdo produkt i prodhuar dhe i tregtuar legalisht në një Shtet Anëtar në përputhje me rregullat e veta të drejta dhe tradicionale, dhe me proceset e prodhimit të atij vendi, duhet të lejohet në tregun e çdo Shteti tjetër Anëtar.

Ky ishte arsyetimi themelor në thelb të debatit për përcaktimin e **parimit të njohjes reciproke**, i cili vepron në mungesë të harmonizimit. Për pasojë, edhe në mungesë të masave të BE-së të harmonizimit (legjislacioni sekondar i BE-së), Shtetet Anëtare obligohen të

lejojnë që mallrat që prodhohen dhe tregtohen legalisht në Shtetet e tjera Anëtare të qarkullojnë dhe të vendosen në tregjet e tyre.

Është me rëndësi të ceket se fusha e zbatimit të nenit 34 të TFBE-së kufizohet nga aktgjykimi "Keck", i cili thotë se disa marrëveshje të caktuara të shitjes bien jashtë fushëveprimit të këtij neni, me kusht që ato të jenë jo-diskriminuese (p.sh. vlejné për të gjithë tregtarët përkatës që veprojnë brenda territorit kombëtar dhe ndikojné në të njëjtën mënyrë, qoftë me ligj apo në fakt, tregtimin e produkteve vendase dhe produkteve nga Shtetet e tjera Anëtare).

Efekti i kësaj praktike gjyqësore është si në vijim.

a) Produktet që prodhohen ose tregtohen në mënyrë të ligjshme në një Shtet Anëtar (ShA) parimisht duhet të lëvizin lirshëm në të gjithë Bashkimin, ku produktet e tilla plotësojnë nivele ekuivalente të mbrojtjes me ato të përcaktuara nga Shteti Anëtar i destinacionit,

b) Në mungesë të legjislacionit të harmonizimit të Bashkimit, Shtetet Anëtare janë të lira të rregullojnë legjislacionin në territorin e tyre, duke iu nënshtruar rregullave të Traktatit për lëvizjen e lirë të mallrave (Art. 34-36 TFBE),

c) Pengesat në lëvizjen e lirë të cilat rezultojné nga ndryshimet në legjislacionin kombëtar mund të pranohen vetëm nëse masat kombëtare:

- janë të nevojshme për të përmbushur kushtet e detyrueshme (siç janë ato të shëndetit, sigurisë, mbrojtjes së konsumatorit dhe mbrojtjes së mjedisit),

- i shërbejnë një qëllimi legjitim që justifikon anashkalimin e parimit të lëvizjes së lirë të mallrave, dhe

- mund të justifikohen me një qëllim legjitim dhe janë proporcionale me qëllimet.

Për të ndihmuar në zbatimin e këtyre parimeve, BE miratoi, së pari Pakon e Mallrave të vitit 2008, Rregulloren (KE) 764/2008 që përcakton procedurat në lidhje me zbatimin e disa rregullave teknike kombëtare për produktet që tregtohen në mënyrë të ligjshme në një Shtet tjetër Anëtar, dhe më vonë në vitin 2019 Rregulloren (BE) 2019/515¹ e cila zëvendësoi dhe shfuqizoi Rregulloren (KE) 764/2008.

Mirëpo, edhe pse i kontribuon dukshëm lëvizjes së lirë të mallrave përbrenda tregut të vetëm, parimi i njohjes reciproke nuk mund të zgjidhë të gjitha problemet dhe edhe kësaj dite mbetet hapësirë për harmonizim të mëtejshëm.

¹ Rregullorja (BE) Nr. 2019/515 mbi njohjen e ndërsjellë të mallrave të tregtuara në mënyrë të ligjshme në një shtet tjetër anëtar dhe shfuqizimin e rregullores (KE) 764/2008. Kosova planifikon të harmonizojë legjislacionin e saj me rregulloren deri në fund të vitit 2022.

II. Zhvillimi i Sistemit Ligjor të Kosovës në lidhje me lëvizjen e lirë të mallrave

Kosova është në proces të përafrimit të sistemit të saj ligjor me atë të BE-së. Në vitin 2016, ky zhvillim i qartë i drejtimit politik mori një bazë zyrtare ligjore duke qenë se **Marrëveshja e Stabilizimit dhe Anëtarësimit (MSA) ndërmjet Kosovës, BE-së dhe Shteteve Anëtare të BE-së** u nënshkrua dhe filloi të zbatohet.

Kërkesat e MSA-së

“Duke pasur parasysh zotimin e Palëve për tregtinë e lirë, në përputhje me parimet përkatëse të Organizatës Botërore të Tregtisë të cilat zbatohen në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese” nën Titullin IV - Lëvizja e lirë e mallrave, MSA përmban disa dispozita kryesore, e që janë relevante për Kapitullin 1 “Lëvizja e Lirë e Mallrave” të *Acquis* të BE-së.

Neni 20 thotë se BE dhe Kosova gradualisht do të krijojnë një zonë të tregtisë së lirë përgjatë një periudhe maksimale prej 10 viteve, duke filluar nga hyrja e MSA-së në fuqi. Neni 22 (“Koncesionet e BE-së për produktet industriale”) thotë që kufizimet sasiore për importet në BE dhe masat me efekt ekuivalent, për produktet me origjinë nga Kosova, shfuqizohen në datën e hyrjes së MSA-së në fuqi. Kosova ka marrë përsipër të njëjtin koncesion (lëshim) ndaj produkteve industriale me origjinë nga BE (neni 23). Në Nenin 24 (“Detyrimet dhe kufizimet mbi eksportet”) të dy palët deklarojnë se hyrja e MSA-së në fuqi shfuqizon të gjitha kufizimet sasiore të eksporteve dhe masat ekuivalente.

Më i rëndësishmi për nevojat e këtij dokumenti është neni 80 i MSA-së i cili thotë:

“Standardizimi, metrologjia, akreditimi dhe vlerësimi i konformitetit

1. Kosova do të **marrë të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që gradualisht të arrijë konformitetin në përputhje me legjislacionin horizontal dhe sektorial të BE-së për sigurinë e produkteve** dhe të sjellë infrastrukturën e cilësisë, siç janë standardizimi, metrologjia, akreditimi dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit, në nivel të standardeve evropiane.

2. Për këtë qëllim, Palët synojnë si në vijim:

- a) të promovojnë përdorimin e rregullave teknike të BE-së, standardeve evropiane dhe procedurave të vlerësimit të konformitetit,
- b) të ofrojnë ndihmë për nxitjen e zhvillimit të infrastrukturës së cilësisë: standardizimi, metrologjia, akreditimi dhe vlerësimi i konformitetit,
- c) të promovojnë bashkëpunimin e Kosovës me organizatat që kanë të bëjnë me standardet, vlerësimin e konformitetit, metrologjinë, akreditimin dhe funksione të ngjashme (p.sh. CEN,

CENELEC, ETSI, EA, WELMEC, EURAMET) në rast se këtë e mundësojnë rrethanat objektive²;

d) sipas nevojës, të lidhet një Marrëveshje për Vlerësimin e Konformitetit dhe Pranimin e Produkteve Industriale (ACAA) sapo korniza legislative dhe procedurat e Kosovës të jenë në përputhje të mjaftueshme me ato të BE-së dhe të jetë zhvilluar ekspertiza e duhur. "

Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA) 2020 - 2024

Disa fragmente nga programi PKZMSA (shkurtuar dhe përshtatur terminologjikisht):

“*Acquis* nga Kapitulli 1: Lëvizja e Lirë e Mallrave, mbulon kërkesat e legjislacionit të BE-së në mënyrë që të sigurojë lëvizjen plotësisht të lirë të produkteve në tregun e brendshëm dhe respektimin dhe zbatimin e parimit të përgjithshëm nga të gjitha Shtetet Anëtare. Për të siguruar respektimin dhe zbatimin e këtij parimi themelor për funksionimin e tregut të brendshëm, në mënyrë që produktet të plotësojnë kërkesat ligjore dhe të tregtohen në tregun e brendshëm të BE-së, zbatimi i këtij kapitulli nga vendet aderuese kërkon që ata "paraprakisht" të përafrojnë të gjithë kornizën e tyre rregullatore në përputhje me atë të BE-së. Kjo nënkupton legjislacionin "qasja e vjetër" (i cili përcakton "specifikimet teknike" për produktet) dhe legjislacionin "qasja e re" (i cili përcakton "kërkesat thelbësore" (shumë më të përgjithshme sesa "specifikacionet teknike" për produktet). Përafrimi i legjislacionit kombëtar arrihet përmes transpozimit të plotë të *Acquis* së BE-së përbrenda fushëveprimit të këtij kapitulli, deri në anëtarësimin e plotë.

Përveç kësaj, nga Kosova si një "vend aderues" kërkohet gjithashtu të zhvillojë dhe zbatojë politikën kombëtare për të siguruar zbatimin e legjislacionit të harmonizuar me *Acquis* të BE-së, dhe për të krijuar dhe funksionalizuar plotësisht të gjithë sistemin institucional të nevojshëm për të zbatuar këtë legjislacion dhe këto politika, në fusha specifike të standardizimit, vlerësimit të konformitetit, akreditimit, metrologjisë dhe mbikëqyrjes së tregut.

Lëvizja e lirë e mallrave është një element kryesor në krijimin dhe zhvillimin e tregut të brendshëm. Nenet 34, 35 dhe 36 të Traktatit për Funksionimin e BE-së (TFEU) parandalojnë Shtetet Anëtare të miratojnë dhe të përcaktojnë kufizime të pajustificuara mbi tregtinë e lirë të mallrave përbrenda tregut të brendshëm, përveç tregtisë përbrenda BE-së. "

² "Rrethanat objektive" i referohen faktit që Kosova nuk është anëtare e "Kombeve të Bashkuara" dhe, në fakt, kjo rrethanë ka një ndikim të dëmshëm në disa nga bashkëpunimet me organet ndërkombëtare në infrastrukturën e cilësisë.

III. Programi për Pajtueshmërinë me Nenet 34 - 36 të TFBE-së

Kjo pjesë e dokumentit është e ndërlidhur me ndikimin e situatës së analizuar në Kosovë në lëminë e pa harmonizuar në zhvillimin e aktiviteteve të planifikuara për periudhën e ardhshme deri në fund të vitit 2025. Kosova do të vazhdojë shqyrtimin e gjendjes në legjislacionin dhe procedurat e saj (të cilat filluan në vitin 2018), duke pasur parasysh dispozitat kryesore të Traktatit për Funksionimin e BE-së ("parimet e përgjithshme"), ashtu siç janë përshkruar në pjesën e parë të këtij dokumenti.

Për zbatimin e nenit 80 të MSA-së, Kosova ka përgatitur Programin për heqjen e pengesave për tregtinë sipas nenit 34– 36 të TFEU.

Programi përbëhet nga pesë aktivitete kryesore:

1. Shqyrtimi i legjislacionit teknik jo të harmonizuar i cili mund të përmbajë "masa me efekt ekuivalent" dhe heqja e pengesave të pajustificuara përmes masave gjegjëse korrigjuese,
2. Shqyrtimi i legjislacionit kombëtar jo-teknik i cili, përmes rregullimeve të shitjes dhe kufizimeve të përdorimit, mund të krijojë pengesa të pajustificuara për tregtinë dhe heqjen e pengesave të pajustificuara përmes masave gjegjëse korrigjuese,
3. Aktivitetet e mëtejshme të MINT - DI DIC, AKS-së dhe ministrive përkatëse të linjës për përmbushjen e detyrimeve, ashtu siç rregullohen me dispozitat e Direktivës (BE) 2015/1535 dhe Rregullores (BE) 1025/2012 të cilat janë transpozuar në rendin ligjor të Kosovës me Rregulloren (GRK) nr. 28/2018 mbi Mënyrën e Njoftimit për Rregulloret Teknike, Procedurat për Vlerësimin e Konformitetit dhe Standardet,
4. Themelimi i pikave të kontaktit për produktet, siç janë qendra të informatave për palët e interesuara, sipas dispozitave të Rregullores (BE) 2019/515 mbi njohjen reciproke të mallrave të tregtuara në mënyrë të ligjshme në një shtet tjetër anëtar,
5. Përgatitjet e autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut për zbatimin e mbikëqyrjes së tregut sipas parimeve dhe dispozitave të Rregullores (BE) 2019/515 mbi njohjen reciproke të mallrave të tregtuara në mënyrë të ligjshme në një shtet tjetër anëtar.

Ad1) Legjislacioni teknik kombëtar jo i harmonizuar

Rregulloret teknike kombëtare jo të harmonizuara janë ato që nuk ka nevojë të harmonizohen me *acquis e BE-së*, pasi kjo e fundit nuk përfshin të gjitha grupet e produkteve dhe / ose aspektet e rrezikut të mundshëm. Rregulloret teknike kombëtare jo të harmonizuara, si rregull, paraqesin një pengesë të mundshme për tregtinë e lirë për shkak të përmbajtjes së tyre që rregullon kërkesa siç janë prezantimi i produkteve (pesha, përbërja, forma, madhësia, etiketimi dhe paketimi), licencat e importit, inspektimet dhe kontrollet ose detyrimet për të caktuar përfaqësuesin ose për të siguruar ambiente magazinimi. Është me rëndësi thelbësore

që të gjitha rregulloret e zbatueshme të regjistrohen dhe analizohen në mënyrë që të hartohet një plan sistematik për menaxhimin e tyre.

Si rregull, në Kosovë nuk ekzistojnë akte të mëvonshme ligjore që do të përfaqësonin bazë ligjore për përfundimin e zbatimit të një numri të madh të rregulloreve teknike të trashëguara nga ish-RSFJ-ja. Kjo është arsyeja se pse edhe rregulloret teknike të trashëguara nga ai shtet duhet të identifikohen, regjistrohen dhe menaxhohen si duhet (gjegjësisht të tërhiqen, të zëvendësohen ose të zbatohen plotësisht). Duhet të themelohet një sistem i shqyrtimit të vazhdueshëm të të gjitha rregulloreve teknike në fuqi, me ç'rast përcaktohet nëse ato janë në përputhje me parimet e Neneve 34 - 36 të TFEU-së.

Ad2) Rregullat kombëtare jo të harmonizuara për rregullimet e shitjes dhe kufizimet e përdorimit

Jo vetëm rregulloret teknike, por edhe "rregullat jo-teknike" kombëtare mund të përmbajnë dispozita të cilat mund të kenë një ndikim të paarsyeshëm të dëmshëm në lëvizjen e lirë të mallrave. Ato kategorizohen në dy klasa kryesore:

- Marrëveshjet e shitjes, dhe
- Kufizimet në përdorim.

Meqenëse p.sh. "emërtimi i origjinës" dhe "detyrimi i përgjithshëm për të përdorur gjuhën kombëtare" janë paraparë në të dy dokumentet e ndryshme mbi temën e përmbajtjes së parimeve të përgjithshme si kufizime tipike të tregtisë, Ligji ekzistues për Mbrojtjen e Konsumatorit do të duhet të analizohet, duke qenë se përmban dispozita në lidhje me këto çështje. Duhet të vlerësohet nga këndi i negociatave të ardhshme me BE-në, nëse disa dispozita mund të përbëjnë pengesa të paarsyeshme për tregtinë.

Legjislacioni kombëtar zakonisht përmban dispozita të cilat, në disa rrethana (p.sh. fushëveprimi tepër i gjerë), mund të identifikohen si pengesa tipike jo-teknike:

- Obligimi i përgjithshëm për të përdorur gjuhën shqipe kur etiketohet një produkt, Obligimi për të emëruar një përfaqësues ose për të siguruar ambiente magazinimi në Kosovë,
- Kontrollat kombëtare të çmimeve dhe rimbursimeve,
- Kufizimet në reklamim (p.sh. duhani, alkooli, lojërat e fatit),
- Kufizimet në përdorim (p.sh. skuterët me ujë, biçikletat në natyrë, makinat e lojërave të fatit në ambiente të caktuara),
- Obligimet e depozitave (p.sh. shishet e kthyeshme),
- Shenjat e origjinës, shenjat e cilësisë, që japin nxitje për blerjen e produkteve kombëtare,
- Kufizimet në shitjeve nga distanca (me anë të internetit, porosisë me postë, etj.).

Ad3) Obligimet sipas dispozitave të Direktivës (BE) 2015/1535 dhe Rregullores (BE) 1025/2012

Të dy aktet ligjore të përmendura të BE-së detyrojnë Shtetet Anëtare të BE-së të njoftojnë Komisionin dhe homologët e tyre për çdo projekt rregullore teknike dhe standarde në lidhje me produktet dhe, që nga viti 1999, shërbimet e shoqërisë së informacionit para se ato të miratohen në ligje kombëtare dhe sistemet e standardizimit (më të rëndësishme prej të cilëve janë "rregulloret teknike jo të harmonizuara"). KE dhe Shtetet Anëtare veprojnë përmes një sistemi të kontrollit preventiv. Gjatë periudhave të bllokimit, Shtetet Anëtare duhet të përmbahen nga miratimi i projekt rregulloreve të njoftuara për të paktën tre muaj teksa janë duke u shqyrtuar. Kjo periudhë mund të zgjatet deri në 18 muaj, kur masa në fjalë mund të krijojë pengesa të pajustificuara në tregti ose kur, në nivel të BE-së, është duke u bërë punë e harmonizimit në lëminë që rregullohet nga drafti i njoftuar.

Prandaj, procedura eliminon çdo pengesë për funksionimin e mirë të tregut të brendshëm para se ato të shfaqen, duke shmangur kështu nevojën për masa retroaktive, të cilat janë gjithmonë më të vështira. Draftet kombëtare iu përshtaten ligjeve të BE-së para se të miratohen dhe madje mund të “vendosen në akull” për një periudhë të caktuar në mënyrë që të lehtësojnë diskutimin në nivelin e BE-së.

Kosova tashmë ka miratuar **Rregulloren (QRK) nr. 28/2018 për Mënyrën e Njoftimit për Rregulloret Teknike, Procedurat Vlerësimit të Konformitetit dhe Standardet**, e cila sipas mendimit të saj, është në përputhje me *acquis* përkatëse të BE-së. Gjatë vitit 2021, MINT - DIC dhe ministritë e linjës do të azhurnojnë dhe lehtësojnë zbatimin e obligimeve ekzistuese në kuadër të CEFTA-s dhe obligimeve të ardhshme nga Marrëveshja me OBT / TBT si dhe në kuadër të legjislacionit të BE për shpërndarjen e informatave dhe procedurave të njoftimit në lëmitë e rregulloreve teknike, standardeve dhe procedurave të vlerësimit të konformitetit.

Ad4 dhe 5) Obligimet sipas dispozitave të Rregullores (BE) 515/2019³

Në vitin 2019, ligjvënësi i BE-së miratoi një rregullore të re që përcakton procedurën për zbatimin e disa rregullave teknike për produktet e tregtuara në mënyrë të ligjshme në një shtet tjetër anëtar. Objektivi kryesor i kësaj rregulloreje është të përmirësojë zgjidhjet ligjore lidhur me të drejtat dhe obligimet e autoriteteve kombëtare dhe bizneseve kur të këta të parët synojnë të mohojnë njohjen reciproke dhe të refuzojnë hyrjen në treg të një produkti që tregtohet në mënyrë të ligjshme në një shtet tjetër anëtar. Republika e Kosovës ka njohje thelbësor të detyrimeve, ashtu siç rregullohen në këtë lëmi me Rregulloren 764/2008 / KE e cila u revokua nga rregullimi që nga viti 2019. Detyra e parë e Kosovës do të jetë azhurnimi i rendit të saj ligjor në mënyrë adekuate dhe pastaj fillimi i zbatimit të duhur.

Rregullorja vë barrën e provës mbi autoritetet kombëtare që synojnë të mohojnë hyrjen në treg. Ata duhet të përcaktojnë me shkrim arsyen e saktë teknike ose shkencore lidhur me synimin e tyre për të mohuar hyrjen e produktit në tregun kombëtar. Operatorit ekonomik i

³ Autoritetet e Kosovës planifikojnë të harmonizojë legjislacionin e saj me rregulloren deri në fund të vitit 2022

jepet mundësia të mbrojë lëndën e tij dhe të paraqesë argumente të qëndrueshme tek autoritetet kompetente.

Rregullorja gjithashtu përcakton 'pikat e kontaktit të produkteve' në secilin Shtet Anëtar, të cilat ofrojnë informata në lidhje me rregullat teknike për produktet dhe zbatimin e parimit të njohjes reciproke për ndërmarrjet dhe autoritetet kompetente në Shtetet e tjera Anëtare.

Në Kosovë, **Ligji për Kërkesat Teknike për Produktet dhe Vlerësimin e Konformitetit** u miratua nga Parlamenti në vitin 2018. Përveç transpozimit të dispozitave përkatëse të Rregullores 765/2008 / EC në lëminë që lidhet me mbikëqyrjen e tregut, Ligji gjithashtu përmban dispozitat e Rregullores 764/2008 / EC, e që janë të rëndësishme për aktivitetet e ardhshme të pikës së kontaktit të produktit, të emëruar në MINT. Edhe para hyrjes në BE, autoritetet publike të Kosovës duhet të krijojnë një rrjet të ministrive përkatëse të linjës, të cilat do t'i sigurojnë publikut të interesuar të gjithë informatat e nevojshme në lidhje me rregullat ligjore për grupe të ndryshme të produkteve në lëminë e harmonizuar dhe jo të harmonizuar.

Në të gjitha autoritetet e mbikëqyrjes së tregut, trajnimi i stafit është planifikuar çdo vit, në përputhje me planin e hartuar nga PKZMSA. Buxheti kombëtar, projektet mbështetëse, TAIEX dhe burime të tjera të mbështetjes janë në dispozicion si burime financiare për aftësim. Duke qenë se **Ligji për Kërkesat Teknike për Produktet dhe Vlerësimin e Konformitetit** mbulon edhe lëmitë e harmonizuara edhe jo të harmonizuara, një pjesë e konsiderueshme e aftësimit në periudhën e ardhshme katër vjeçare planifikohet të orientohet drejt zbatimi të duhur të Rregullores (BE) 2019/515 në lidhje me zbatimin e ardhshëm të klauzolës së njohjes reciproke. Kjo do t'u mundësojë inspektorëve që të jenë plotësisht të përgatitur për marrjen e masave të nevojshme për të gjitha produktet në treg duke marrë parasysh dallimet e rëndësishme ligjore në lidhje me "produktet e harmonizuara dhe jo të harmonizuara".

Korniza institucionale

Çështjet ligjore të lartpërmendura në Kosovë nuk mund të analizohen dhe të trajtohen vetëm nga një autoritet qeveritar. Kompleksiteti i temës kërkon një bashkëpunim të ndër-sektorial të menaxhuar mirë. Zbatimi i planit të veprimit kërkon një infrastrukturë institucionale komplekse e cila përbëhet nga disa subjekte.

Përveç ministrive të linjës, të cilat janë të ngarkuara me hartimin dhe zbatimin e legjislationit për grupe të ndryshme të produkteve, duhet të përmendet edhe Inspektorati i Tregut pasi do të jetë autoriteti më i rëndësishëm për ekzekutimin e një roli mjaft të vështirë të mbikëqyrjes së produkteve në treg, të cilat janë në lëminë e rregullave jo të harmonizuara dhe parimeve ligjore në fuqi. Inspektoratet kompetente të ministrive të tjera, si p.sh. ato të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë, si dhe Administratës Doganore, do të kontribuojnë në zhvillimet e kërkuara përmes Trupit Koordinues të Mbikëqyrjes së Tregut.

Puna e vazhdueshme e ministrive duhet të jetë e koordinuar mirë për të themeluar dhe mirëmbajtur një kornizë koherente dhe transparente ligjore dhe për të siguruar zbatimin uniform të rregullave të parapara.

MINT është përgjegjëse për ekzekutimin e të gjitha obligimeve të koordinimit në lëminë e lëvizjes së lirë të mallrave dhe në zbatimin e legjislacionit në lëminë e pa harmonizuar, përveç MINT, janë edhe pesë ministri të tjera:

- Ministria e Ekonomisë (ME);
- Ministria e Shëndetësisë (MSh);
- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI);
- Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)
- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR)

Aktiviteti i vazhdueshëm juridik - Dy ekspertëve ligjorë nga MINT, që nga fillimi i tremujorit të tretë 2021, do t'u jepet detyra e qartë për të ndjekur vazhdimisht çështjet gjyqësore të GJED-së si dhe çështjet gjyqësore përkatëse të Kosovës, për të kontribuar në raportet e lartpërmendura vjetore si dhe për të ndihmuar hartuesit e legjislacionit përkatës të ardhshëm të Kosovës që gjithmonë të marrin parasysh parimet ligjore dhe rregullat e parapara në Nenin 34 - 36 TFEU.

IV. Miratimi dhe zbatimi i Programit

Programi me të dy anekset do të dërgohet nga MINT në Qeverinë e Kosovës (QK) për miratim, ku është paraparë **një procedurë me dy hapa**:

Hapi 1 - Pritet që QRK të miratojë Programin deri në fund të tremujorit të dytë të 2021. Qeveria e Kosovës do t'u kërkojnë ministrive të kontrollojnë dy listat dhe të ofrojnë informata prapavajtesë, të cilat duhet të shpjegojnë masën korrigjuese për secilin akt ligjor në listë:

- A** - Shfuqizimi i aktit juridik,
- B** - Përfshirja e klauzolës së njohjes reciproke (KNjR)⁴ në rregullimin teknik,
- C** – Shfuqizimi i dispozitave që mund të jenë pengesë e pajustificuar për tregtinë (p.sh. zëvendësimi i standardeve të referuara),
- D** - Shfuqizimi në kuadër të procesit të miratimit të legjislacionit të BE-së për harmonizim (zëvendësimi me akt të ri ligjor në procesin e harmonizimit),
- E** - Nuk ka nevojë për veprim pasi akti juridik është në përputhje me Nenin 34-36.

⁴ Komisioni dëshiron që Shtetet Anëtare (dhe vendet aderuese) të përfshijnë, në ligjet e tyre kombëtare, një klauzolë të njohjes reciproke, e hartuar për të zbatuar në mënyrë të drejtë parimin e njohjes reciproke. Kjo klauzolë përfshihet në aktet ligjore kombëtare dhe duhet të lejojë tregtimin e produkteve të prodhuara ligjërisht dhe / ose të tregtuar në një shtet tjetër anëtar.

Hapi 2 - Ministritë e linjës, të koordinuara nga MINT, duhet të përgatisin raportin e parë për QRK një vit pas miratimit të Programit nga QRK-së, ku përshkruhen masat e planifikuara korrigjuese. Në raport, ata duhet të përfshijnë të gjitha elementet e Programit (p.sh. statistikën mbi njoftimin rreth rregulloreve teknike, trajnimin e inspektorëve). Gjatë planifikimit të masave korrigjuese, ata duhet të marrin parasysh afatin kohor të dhënë për ekzekutimin e masave korrigjuese të nevojshme, të cilat nuk mund të shkojnë përtej fundit të vitit 2025.

Nëse është e nevojshme, ministritë e linjës duhet të zgjerojnë listën duke shtuar rregullore të tjera të identifikuar si pengesë e mundshme për lëvizjen e lirë të mallrave dhe të planifikojnë masat e nevojshme, në përputhje me rrethanat.

Deri në fund të janarit të çdo viti brenda periudhës 2023 - 2026, MINT duhet t'i paraqesë QRK-së një raport vjetor për realizimin e programit dhe për aktet e analizuara legjislative dhe procedurat administrative të cilat mund të kenë ndikim negativ në lëvizjen e lirë të mallrave në Kosovë.

Kjo formë e monitorimit të vazhdueshëm të dinamikës së zbatimit të Programit hartohet për të mundësuar shpërndarje të barabartë të ngarkesës së punës të institucionet e përfshira të Kosovës, gjatë afatit kohor të zbatimit. Rishikimi zyrtar i planifikuar të kryhet në janar 2026 duhet në veçanti të përdoret për të rivlerësuar gjendjen në lidhje me zbatimin dhe, nëse është e nevojshme, mund të shpie në rishikim zyrtar të orarit të planifikuar. Për nga natyra, Programi është një aktivitet i vazhdueshëm i hapur, pasi parandalimi i vazhdueshëm i pengesave të pajustificuara ndaj tregtisë është një nga gurët themelorë të tregut të vetëm.

SHTOJCAT

Shtojca 1

Lista e rregulloreve teknike për produktet që mund të përmbajnë dispozitat jo të harmonizuara

Shtojca 2

Lista e rregulloreve jo-teknike që mund të përmbajnë pengesa për tregtinë (p.sh. kontrollet e çmimeve, kufizimet në reklamë)